



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI KOMITETI PËR KOMUNITETE

### EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 7 qershor 2011, në mbledhjen e XIV (katërbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve nr. 31 dhe filloi në orën 11.05.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blakçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj , z. Radisav Peroviq , z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe të ftuarit z. Muharrem Haziri, OSBE , z. Attila Nagy, LMT – KFOR- Hungarez dhe z. Kunistah LMT-KFOR- Çek.

#### 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, propozoi që në rend dite të përfshihet edhe:

- Raporti për situatën e sigurisë në Komunë.

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri me propozimin e paraqitur.

#### 2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 10 maj 2011

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

#### 3. Raporti për situatën e sigurisë në Komunë

**z. Kunistah**, theksoi, fillimisht dua të prezantoj z. Attila Nagy, udhëheqës i LMT – KFOR- it Hungarez, kontingjent i cili brenda muajit do ta zëvendësojë LMT-KFOR-in Çek dhe shtoi, situata e sigurisë në Komunën e Podujevës në përgjithësi është e qetë pa probleme të theksuara.

#### 4. Shqyrtimi i shqetësimeve për kalimin e vijës kufitare gjatë ardhje – vajtjes të vizitorëve tek të afërmit e tyre në lagjen e sekiraqëve në fshatin Metergoc.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, e paraqiti fjalën e hyrjes.

**z. Radisav Peroviq**, theksoi, ditëve të fundit është ashpërsuar kontrolli në vijën kufitare dhe asnjë vizitori nuk i është lejuar kalimi duke përfshirë edhe personat të cilët kanë dashur të shkojnë në shtëpitë e tyre të boshatisura. Gjithashtu edhe unë personalisht kam pasur problem kur kam shkuar në Medvegj për të blerë zarzavate dhe me rastin e kthimit Udhëheqësi i njësisë së policisë më ka thënë se as unë nuk mund të kalojë ngase nga strukturat e larta e ka urdhrin që të mos lejohet askush të kalojë vijën kufitare, kjo nuk më ka ndodhur kurrë, por me atë rast më është lejuar vetëm të dërgoj zarzavatet në shtëpi dhe jam kthyer pas 15 minutash, mirëpo të nesërmen policia në përgjegjësi të saj më ka lejuar të shkojë në shtëpi. E gjithë kjo më ka shqetësuar pa masë ngase në atë trevë jetojmë 8 pjesëtarë serb të moshuar shumica e të cilëve janë invalid.

Lidhur me këtë çështje kam kërkuar takim me Kryetarin e Komunës të cilin e falënderoj dhe për sjelljen korrekte dhe mundësimin e takimit me përfaqësuesit e strukturave tjera kompetente në mënyrë që të shqyrtohen mundësitë për zgjidhjen e mundshme të këtij problemi, edhe pse jam në dijeni se kjo çështje nuk është në kompetencë të Kryetarit të Komunës.

Fqiu, përfundoi ky diskutues, ju ka vjedhur traktori, janë vjedhur tri lopë e po ashtu edhe pylli në vazhdimësi prehet në mënyrë ilegale dhe për gjitha këto nuk është zbardhur asnjë rast, pastaj si të arsyetohet rasti kur një person vjen për ta rregulluar ujësjellësin në shtëpinë e tij, e zen policia dhe nga Gjykata dënohet me 400,00 €.

**z. Burhan Blekçori**, theksoi, nuk është i ri problemi të cilin e shtroi parafolësi, për këtë çështje jemi njoftuar edhe më parë dhe në mbledhje të këtij Komiteti e kemi shqyrtuar si pikë të veçantë, përndryshe e ndajmë shqetësimin tonë me z. Radisavin. Jeni në dijeni se ne në cilësinë e Komitetit për Komunitete për zgjidhjen e kësaj çështjeje ju kemi drejtuar Kabinetit të Kryeministrit – Zyrës për Komunitete. Mbetet të shpresojmë se bisedimet Kosovë – Serbi do të jenë frytdhënëse ngase është paralajmëruar se në fund të këtij muaji do të arrihen disa marrëveshje dhe në këtë kontekst sigurisht do t'i vjen radha edhe zgjidhjes së kësaj çështjeje.

**z. Nebih Behluli**, theksoi, nuk dua ta përsëris ato çka i tha parafolësi, mirëpo jam i mendimit se z. Radisav dhe pjesa tjetër e komunitetit serb duhet që për gjendjen dhe shqetësimet e tyre të ushtrojnë presion dhe trysni te pala serbe në mënyrë që të shqyrtohen mundësitë për hapjen e pikës kufitare në atë trevë e kjo do të ndodhë nëse Kosova dhe Serbia e vlerësojnë interes të dyanshëm. Përndryshe pala kosovare në vazhdimësi është përpjekur për sigurimin e lëvizjes së lirë të pjesëtarëve të komunitetit serb dhe në këtë aspekt ka bërë lëshime të mëdha siç është rasti i lejimit të qarkullimit të automjeteve pa targa. Sigurisht jeni të informuar se në fshatin Tashefc edhe barinjët nëse e kalojnë pikën kufitare ata dërgohen në Prokuple dhe nga Gjykata iu shqiptohet dënimi përkatës.

Ne e kemi vullnetin e mirë dhe dëshirën për t'i ndihmuar ata banorë në tejkalimin e problemit të cekur, mirëpo kjo çështje nuk varet dhe nuk është në kompetencë të nivelit lokal por të nivelit qendror, ku edhe duhet kërkuar zgjidhja. Në fund dua të them edhe këtë se një pjesë e madhe e njerëzve janë në pritje të arritjes së marrëveshjes Kosovë – Serbi dhe zgjidhjes së shumë çështjeve të rëndësishme duke përfshirë edhe çështjen për të cilën po debatojmë.

**z. Radisav Peroviq**, theksoi, ju falënderoj për mirëkuptim, mirëpo derisa delegacionet bisedojnë unë dhe bashkëvendësit e mi përballemi me probleme,

pak më parë ju informova se edhe mua personalisht nuk më është lejuar kalimi i vijës kufitare dhe shkuarja në shtëpi, më është thënë Rashko t'i nuk mund të kalosh, këto janë momente shumë të vështira dhe kurrë nuk e kam paramenduar se do të më ndodhë një gjë të tillë dhe përfundoi, prej se KFOR-i ka ardhur në Kosovë probleme të këtilla nuk kam pasur.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, ne duhet të insistojmë te strukturat kompetente të Nivelit Qendror për zgjidhjen e kësaj çështjeje , mirëpo pasi kanë filluar bisedimet Kosovë – Serbi jam i bindur se do të tejkalohet edhe ky problem.

**z. Nebih Behluli**, nënvizoi, jam i mendimit se Radisav Peroviqi dhe Millomir Jovanoviqi për zgjidhjen e këtij problemi duhet të angazhohen edhe te pala serbe në mënyrë që kjo çështje të zgjidhet përmes strukturave përkatëse shtetërore të Kosovës dhe Serbisë.

**z. Radisav Peroviq**, theksoi ju të gjithë e njihni Millomir Jovanoviqin i cili në shtëpinë time është arrestuar me Ivica Markoviqin me arsyetim se e kanë kaluar kufirin në vendin ku nuk ka pikë kufitare.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, për zgjidhjen e këtij problemi duhet të kontaktohet Kabineti i Kryeministrit të Kosovës – Zyra për Komunitete.

**z. Radisav Peroviq**, u pajtua me parafolësin dhe shtoi, dëshira ime është që ndonjë përfaqësues i Nivelit Qendror të vjen tek ne për vizitë dhe në vendin e ngjarjes të informohet për së afërmi me brengat dhe shqetësimet tona.

## **5. Të ndryshme**

Nuk pati diskutime.

**Mbledhja përfundoi në orën 11.55**

**Procesverbalin e mbajti**

**Faik Gashi**

**Nr. 01/141-06**

**Podujevë,**

**7 qershor 2011**

**Kryesuesi i Komitetit  
Shaban Ahmeti**